

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SPECIALIST ARKIVI

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë specialist arkivi, që që do të kryejë detyrat e ngarkuara në ligj dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në nivelin Master Shkencor për arkiva, drejtësi ose ekonomi.
- Mundësisht të ketë përvojë profesionale si specialist arkivi.

Personat e interesuar duhet të paraqitin në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim ku të jepen adresa dhe numri i kontaktit;
2. Fotokopjen e diplomës dhe të listes te notave, të noterizuara;
3. Dëshmi të eksperiencës së punës, veçanërisht të si arkiviste ose dëshmi të përfundimit të një kursi profesional për specialist arkivi.
4. Një CV ku të përshkruhet qartë eksperiencia e punës;

Kandidatët mund të paraqitin:

- Dëshmi të kualifikimeve pas universitare;
- Dëshmi të njohurive në programet kompjuterike MSOffice- Word dhe Excel;
- Një certifikatë personale ose fotokopje të kartës të identitetit;
- Dëshmi për zotërimin e gjuhëve të huaja.

Pikësimi që do të përdoret për renditjen e kandidatëve do të jetë:

- | | |
|---|------------|
| • Mesatarja e notave niveli Bachelor | 0-20 pikë |
| • Mesatarja e notave Master Shkencor | 0-20 pikë |
| • Eksperiencës së punës | 0-10 pikë |
| • Dëshmi për gjuhë të huaja dhe kualifikime | 0- 5 pikë |
| • Intervista | 0- 15 pikë |
| • Provimi me shkrim | 0- 30 pikë |
- Provimi me shkrim do të konsistojë në ligjin për arkivar dhe aktet nënligjore përkatëse. Kandidatët do të njoftohen me telefon për datën e provimit.

Pranimi i aplikimeve mbyllet në datën 06.01.2026.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë